



REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA KOMBETARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
ZYRA NOTERIALE ELBASAN
NR. 2297 REP. NR. 786 KOL.



Tel: +355 693414199

email: armandshqarri@hotmail.com

KONTRATE SHITJE

(Pasuri e luajtshme, Kuotash ne kapitalin e shoqerisë)

Sot me 26/06/2019 (qershor dymije e nentembedhjetë) perpara meje Noterit Publik, Armand Shqarri, Anetar prane Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Durrës, ne zyren time noteriale me seli ne Elbasan L."5 Maj", u paraqiten personalisht shtetasit shqiptar, me poshte referuar si pale.

PALET NE KONTRATE

- **PALA SHITESE:** **Z. SEFER TROKA**, atesia Rexhep, lindur me 06.02.1968, ne Cërrik, Elbasan dhe banues ne Shalës, Kurtalli, Elbasan, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me ane te leternjoftimit me nr. 034233676 dhe nr. Personal G80206012E, ortak i vetem prane shoqerise "**TROKA NET**"shpk, me nr. NIPT L82928202L.
- **PALA BLERESE:** **Z. KELMEND RAMA**, atesia Tomorr, lindur me 15.07.1984, ne Shalës, Elbasan dhe banues ne Shalës, Elbasan, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me ane te leternjoftimit me nr. 030920838 dhe nr. Personal I40715223U.

Pala shitëse **Sefer Troka**, është zotërues i 100 % (njqind perqind) te kapitalit te shoqerise me vlerë 4 000 000 (kater milion leke) në Shoqërinë "**TROKA NET**"shpk, (më poshtë referuar si shoqëria.)

Shoqëria është regjistruar pranë QKB me NIPT L82928202L, me adrese ne Elbasan Shales Bashkia Cërrik, Njesia Administrative Shales, Elbasan km 1, zona kadastrale nr.3312, pasuria nr.181/3.

Pala shitëse dëshiron t'i shesë pales blerese, 30 % të kapitalit themeltar që zotëron dhe pala blerese dëshiron të blejë sipas kushteve të kësaj kontrate dhe bëhet pronar ne masen 30% te kapitalit te shoqërisë "**TROKA NET**"shpk, Z. Sefer Troka, pas nenshkrimit te kontrates se shitjes zoteron 70% te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 2 800 000 (dy milion e teteqind mije leke te rinj) LEKE dhe **administrator mbetet Sefer Troka**.

Në përputhje me nenin 73 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare», neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e shitjes", dhe në përgjithësi të legjislacionit shqiptar në fuqi, hartohet kontrata e shitjes së kuotave si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, pala shitese i shet nëpërmjet kontrates shitblerjes 30 % të kapitalit te shoqerise ne vleren 1 200 000 LEKE, (nje milion e dyqind mije leke te rinj) të zotëruar në shoqëri si dhe të drejtën e pronësisë mbi kapitalin e shoqerise dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje pales blerese, duke e garantuar plotësisht titullin e pronësisë të pa rënduar me barrë. Pala shitese mbetet me pronar per 70% te kapitalit themeltar te shoqerise, ne vleren 2 800 000 (dy milion e teteqind mijee leke te rinj) LEKE.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

Çmimi i plotë i shitjes së 30% te kapitalit themeltar te shoqerise është ne vleren 1 200 000 (nje milion e dyqind mije leke te rinj) LEKE.

Neni 3

Menyra e likuidimit

Çmimi total i shitjes paguhet nga pala blerese jashtë zyrës noteriale.

TROKA NET SHPK
NIPT
L82928202L

Neni 4

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

Kalimi i pronësisë së ligjshme për 30% të kapitalit themeltar në vlerën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë leke të rinj) LEKE, nga pala shitese tek pala blerese, do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe depozitim të kontratës në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Garancitë

Shitësi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton Blerësin:

Se është pronar i vetëm i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e shitura.

Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.

Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.

Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme të shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

Neni 6

Regjistrimi

Regjistrimi i kalimit të kuotave nga Shitësi te Blerësi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 7

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Elbasan.

Neni 9

Të ndryshme

Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.

Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve duke respektuar formën shkresore të noterizuar.

Kjo kontratë u përpilua në 4 (katër) kopje me vlerë të barabartë ligjore. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt, nga palët, para meje, dhe unë noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

PALA SHITËSE

"Troka Net" shpk

Seler
TROKA NET SHPK
NIPPT
L82928202L

Noteri

Armand S. Shqarri



PALA BLERËSE

KELIEND RANA